

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Mentor Bajraktari, me procesmbajtësen Lamije Kuqi– sekretare juridike pranë kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarit V. B. nga Gjakova, për shkak të veprës penale mundësimi ose detyrimi në prostitucion nga neni 241 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, me numër PP/II.nr.303/2016, të datës 22.03.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me datë 06.06.2016, në prezencën e Prokurorit të shtetit I. T., të dëmtuarës B. H., mbrojtësit të viktimave A. P., të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij avokatit G. G. nga Gjakova, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

V. B., nga i ati S., e ëma E., e gjinisë Sh., i lindur me datë... në Gjakovë, ku edhe tani banon, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendje së dobët ekonomike, shqiptar - shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse që nga muaji Tetor 2013, në vazhdimësi gjerë me datën 18.11.2015 duke përdorur kanosjen serioze, ka detyruar të dëmtuarën B. H. nga Gjakova, me të cilën ka qenë në bashkësi jashtëmartesore, që të merret me prostitucion në atë mënyrë që e dëmtuara B. duke qenë në situatë të varësisë personale ndaj të pandehurit V. i cili të dëmtuarën B. e detyron që të ketë marrëdhënie seksuale me personat- dëshmitarët F. M. dhe A. T. që të dy nga Gjakova, si dhe dëshmitarin P. P. nga fshati D. Komuna e Gjakovës, dhe atë në lokalitetet dhe vende të ndryshme në territorin e Komunës së Gjakovës, si në banesën e të pandehurit, në zyrat e kompanisë “A. T.”, në lagjen Dardania në afërsi të restorantit “J. S.”, në hotelin “J.”, në hotelin “E.” si dhe në automjetet e tipit “Golf” dhe “Mercedes” pronë e P. P., ashtu që për shërbimet e kryera seksuale të të dëmtuarës, i akuzuari V., nga ana e këtyre personave është furnizuar me substancë narkotike të llojit heroinë e të cilën substancë narkotike e kanë konsumuar i akuzuari si dhe e dëmtuara.

Me këto veprime ka kryer veprën penale mundësimi ose detyrimi në prostitucion nga neni 241 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par. 1, 41, 42, 43, 45, 46, 73, 74, 75, 83 dhe nenit 241 par.3 lidhur me par. 1 të KPRK-së, të akuzuarin e:

G J Y K O N

ME DËNIM ME GJOBË në shumë prej 600 (gjashtëqind) Euro, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguajë në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe

ME DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) muajve, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 18.11.2015 deri me datën 06.06.2016.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë, gjykata do ta zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burg në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë) ditëve, duke ia llogaritur për çdo ditë të kaluar në burg nga 20 (njëzet) €uro.

E dëmtuara B. H. nga Gjakova, rruga..., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko - civil.

Obligohet i akuzuari V. B. që të paguajë shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej 100 (njëqind) €uro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, pranë kësaj gjykate, ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.303/2016, të datës 22.03.2016, kundër të akuzuarit V. B. nga Gjakova, për shkak të veprës penale mundësimi ose detyrimi në prostitucion nga neni 241 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së. Prokurori i shtetit Ismet Tofaj gjatë shqyrtimit gjyqësor ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarit V. B., andaj ka propozuar që i njëjti të shpallët fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I akuzuari V. B. gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet dhe ka shtuar se është penduar për veprën penale.

Në fjalën përfundimtare Prokurori i shtetit Ismet Tofaj ka deklaruar se me pranimin e fajësisë që u bë lirshëm dhe vullnetshëm nga i akuzuari, deklaratës së të dëmtuarës, deklaratës së dëshmitarëve si dhe provave tjera materiale, është vërtetuar mjaftë se i akuzuari me datë, kohë dhe vend sipas aktakuzës PP/II.nr. 303/16 të datës 22.03.2016, ka kryer veprën penale mundësim ose detyrim në prostitucion nga neni 241 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së, andaj kësaj gjykate i propozoi që të akuzuarin ta shpall fajtor për veprën penale, të dënoi në bazë të ligjit, dhe gjatë matjes dhe caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, si rrethanë lehtësuese gjykata të merr parasysh pranimin e fajësisë, si dhe rrethanat tjera të cilat i vlerëson gjykata si dhe gjykata nëse gjen edhe rrethanat rënduese ti merr për bazë.

Në fjalën përfundimtare e dëmtuara B. H. ka deklaruar se e mbështes në tërësi fjalën përfundimtare të Prokurorit të Shtetit, dhe si e dëmtuar sa i përket kërkesës pasurore –juridike deklaroi se unë parashtroi kërkesë pasurore-juridike ndaj të akuzuarit dhe kërkoi që të më kompensohet dëmi.

Në fjalën përfundimtare mbrojtësi i viktimave A. P. ka deklaruar se në tërësi e mbështes fjalën përfundimtare të Prokurorit të Shtetit dhe fjalën përfundimtare të dëmtuarës B. H.

Në fjalën përfundimtare mbrojtësi i të akuzuarit av. G. G., deklaroi se do të bazoi në dispozitat e kodit penal që rregullojnë çështjen e matjes së dënimit, duke u bazuar në nenin 73 e deri te neni 76 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Meqenëse organi i akuzës në raport me të akuzuarin V. B., nuk ka ofruar asnjë rrethanë rënduese që do të ndikonte në ashpërsimin e dënimit, gjykata me rastin e vendimmarrjes sipas mendimit tonë nuk ka mundësi që të zbatoi rregullat e përgjithshme për ashpërsimin e dënimit në bazë të rrethanat rëndueses të përcaktuar në dispozitën e neni 74 par.2 të KPRK-ës, Gjukata në mungesë të rrethanat rënduese me rastin e vendimmarrjes për llojin dhe lartësinë e dënimit, vendimin e vetë duhet ta mbështetë vetëm mbi rrethanat lehtësuese të përcaktuar në nenin 74 par.3 të KPRK-ës, rrethana që gjykata duhet ta vlerësoi si lehtësuese, është në rend të parë pranimi i fajit. Lidhur me këtë rrethanë gjykata e ka

të njohur që nga praktika gjyqësore dhe në veçanti sipas vendimeve të Gjykatës së Apelit, pranimi i fajit nga i akuzuari nuk pranohet dhe vlerësohet vetëm si rrethanë lehtësuese, por e njëjta mirëet dhe konsiderohet si posaçërisht lehtësuese. Rrethanë tjetër që gjykata duhet të vlerësoi është sipas KPRK-ës, kur bëhet fjalë për rrethanat personale dhe karakteri i personit të akuzuarit. I akuzuari V. është i moshës relativisht të re, është i pa martuar, i pa punë, jeton në bashkësi vetëm me nënën e tij, e cila po ashtu është në moshë relative të vjetër dhe e cila është e sëmur e për të cilën i akuzuari si i vetmi bashkëjetues i saj, i njëjti duhet të kujdeset për nënën. Gjithashtu sa i përket gjendjes ekonomike i akuzuari bashkë me nënën e vetë qëndrojnë ekonomikisht jo të mirë, nga se që të dytë janë të pa punësuar. I akuzuari V. nuk ka pasuri të luajtshme apo të paluajtshme në emër të tij, gjithashtu gjatë gjithë procedurës penale i akuzuari ka pasur sjellje të mirë dhe korrekte si me organin hetimor ashtu edhe me gjykatën, dhe sjelljet e mira ka pasur edhe në qendrën e paraburgimit, i akuzuari V. siç u deklarua edhe vetë është penduar thellë për kryerjen e veprës penale e cila i vihet në barrë, andaj në fund i propozojmë gjykatës që me rastin e matjes së dënimit përveç rrethanave lehtësuese që i cekëm në këtë fjalë përfundimtare, sipas detyrës zyrtare të lëshohet edhe në vlerësimi e ndonjë rrethane tjetër e cila nuk është përfshirë në këtë fjalë përfundimtare, e pastaj në mbështetje të nenit 75 par.1 pika 1.2 të zbatoi institutin penal juridik të zbutjes së dënimit në harmoni me nenin 76 të KPRK-ës, respektivisht i propozoi Gjykatës që ndaj të akuzuarit ti shqiptohet dënimi në kohëzgjatje për aq kohë e cila do të ia mbulonte kohën e kaluar në paraburgim dhe i propozojmë gjykatës që me që i akuzuari e pranoi fajësinë menjëherë të i nder prehët paraburgimi sepse me pranimin e fajësisë, pushojnë të gjitha arsyet apo shkaqet për të cilat i akuzuari është mbajtur në paraburgim.

Në fjalën përfundimtare i akuzuari V. B., ka deklaruar se në tërësi e mbështet fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij Av. G. G., dhe ka shtuar se më vjen keq për rastin që ka ndodhë, i kërkoi falje të dëmtuarës B., dhe i premtoi Gjykatës që nuk do të përsërisë veprime të tilla.

Në shqyrtimin gjyqësor gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari V. B. që nga muaji Tetor 2013, në vazhdimësi gjerë me datën 18.11.2015 duke përdorur kanosjen serioze, ka detyruar të dëmtuarën B. H. nga Gjakova, me të cilën ka qenë në bashkësi jashtëmartesore, që të merret me prostitucion në atë mënyrë që e dëmtuara B. duke qenë në situatë të varësisë personale ndaj të pandehurit V. i cili të dëmtuarën B. e detyron që të ketë marrëdhënie seksuale me personat- dëshmitarët F. M. dhe A. T. që të dy nga Gjakova, si dhe dëshmitarin P. P. nga fshati D. Komuna e Gjakovës, dhe atë në lokalitetet dhe vende të ndryshme në territorin e Komunës së Gjakovës, si në banesën e të pandehurit, në zyrat e kompanisë “A. T.”, në lagjen Dardania në afërsi të restorantit “J. S.”, në hotelin “J.”, në hotelin “E.” si dhe në automjetet e tipit “Golf” dhe “Mercedes” pronë e P. P., ashtu që për shërbimet e kryera seksuale të dëmtuarës, i akuzuari V., nga ana e këtyre personave është furnizuar me substancë narkotike të llojit Heroinë e të cilën substancë narkotike e kanë konsumuar i akuzuari si dhe e dëmtuara.

Gjykata gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari, i cili në shqyrtimin gjyqësor vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij av. G. G. nga Gjakova, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale mundësimi ose detyrimi në prostitucion nga neni 241 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpall fajtor dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: është i pa punë, i gjendje së dobët ekonomike, në gjykim ka pas qëndrim tejet korrekt, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale, më parë nuk ka qenë i dënuar, ndërsa si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë në shqyrtimin gjyqësor si dhe pendimin e tij për veprën penale të kryer dhe keqardhjen e shfaqur duke i kërkuar falje të dëmtuarës, për shkak të së cilave gjykata ka aplikuar dispozitat për zbutjen e dënimit nga neni 75 të KPRK-së. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin me gjobë në shumë prej 600 Euro të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguajë në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe me dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 10 muajve, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 18.11.2015 deri me datën 06.06.2016, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 i KPRK-së, ngase me dënimet e lartpërmendura të shqiptuara kryesi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tij dhe do të ndikojë në përmbajtjen e personave tjerë nga kryerja e veprave penale dhe se këto dënime si të tilla të shqiptuar sipas bindjes së gjykatës janë në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike ne kontest civil është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 463 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 2 të KPP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 450 par.2 nënpar 2.6 lidhur me nenin 453 par.1. të KPP-së.

Me sa u tha më lartë u vendo

s si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti i përgjithshëm -
P.nr.165/16, me datë 06.06.2016

Procesmbajtësja,
Lamije Kuqi

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Mentor Bajraktari

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.